

LIGJ
Nr.7549, datë 14.1.1992

PËR METODAT E PUNËS TË POLICISË KRIMINALE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Policia kriminale është sektor i specializuar i policisë së rendit për të luftuar kriminalitetin.

Neni 2

Veprimtaria e policisë kriminale bazohet në dispozitat kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në Kodin e Procedurës Penale, në ligjin "Për policinë e rendit" dhe për metodat e veçanta të punës së saj, në dispozitat e këtij ligji.

Neni 3

Për veprimtari kriminale ndiqen vetëm personat për të cilët ka të dhëna se kanë kryer, kryejnë a përgatiten të kryejnë vepra penale.

Neni 4

Për të zbuluar, dokumentuar e parandaluar veprimtarinë keqbërëse, policia kriminale mbështetet te informacioni, përdor mjete zbuluese speciale dhe metoda e mjete tekniko- kriminalistike.

Si burim informacioni mund të shërbejë çdo person fizik. Policia kriminale mund të marrë informacion edhe nga persona të implikuar në veprimtari kriminale.

Informimi bëhet mbi bazën e vullnetit të lirë të personit.

Neni 5

Personat që ndihmojnë për parandalimin e zbulimin e krimeve, shpërblehen nga policia kriminale sipas kriterëve që caktohen nga Ministri i Rëndit Publik.

Kur për shkak të veprimtarisë së tyre informative, këtyre personave u rrezikohet jeta, Ministria e Rëndit Publik merr masa për mënjanimin e rrezikut.

Neni 6

Mjetet zbuluese speciale mund të përdoren vetëm për të vërtetuar verimtarinë kriminale me rrezikshmëri të theksuar dhe kur të dhënat e nevojshme nuk mund të sigurohen në mënyrë tjetër.

Neni 7

Leja për përdorimin e mjeteve zbuluese speciale jepet nga drejtuesi i policisë kriminale, pasi merret miratimi i prokurorit të rrethit dhe mund të vazhdojë jo më shumë se 6 muaj.

Neni 8

Të dhënat që janë grumbulluar nëpërmjet mjeteve zbuluese speciale nuk mund të përdoren në dëm të personit që i përket, me përjashtim të rasteve të krimit të kryer dhe kur ato kanë lidhje të drejtpërdrejtë me të. Ato u vihen në dispozicion organeve të hetuesisë vetëm me urdhër të ministrit të Rendit Publik. Të dhënat që nuk kanë lidhje me krimin e kryer asgjësohen.

Në rastet e një rreziku të menjëhershëm për përgatitjen e akteve terroriste e të grabitjes, të dhënat e mjeteve zbuluese speciale mund të vihen në dispozicion të organeve të hetuesisë, sipas kërkesës së tyre.

Neni 9

Personat që për shkak të detyrës kanë dijeni për fakte e të dhëna për mjetet zbuluese speciale, të cilat janë përdorur sipas kushteve e rrethanave të këtij ligji, janë të detyruar të ruajnë sekretin e tyre.

Neni 10

Policia kriminale shkëmben informacion me Shërbimin Informativ Kombëtar, Shërbimin Informativ Ushtarak, policitë e shteteve të tjera dhe organet policore ndërkombëtare.

Neni 11

Ministri i Rendit Publik duhet të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji, brenda dy muajve nga hyrja në fuqi.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.112, datë 23.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.